

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje karburant, nafte (Diesel) Bashkia Mirditë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV- 09134000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 12 257 500 (Dymbëdhjetemilion e dyqind e pesëdhjetete shtatemije e peseqind) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti kontraktor Bashkia Mirditë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formulari i ofertes, sipas shtojcës 1/1;

(referuar vkm 285 dt.19.05.2021, ndryshuar me vkm nr.710 dt.24.11.2021)

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 8).

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe Vendimit nr.2 datë 09.06.2021 “Për miratimin e dokumentave standarte të tenderit për mallra,punë,shërbime për procedurën e prokurimit “procedurë e hapur”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim xhiroje vjetore nga Administrata Tatimore për 3 (tre) vitet e fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Kjo kerkese konsiderohet e permbushur nëqoftëse Operatorët Ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga AK si më lart.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare perkatësisht 2021,2022 dhe 2023, Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti OE duhet te paraqese kopje te bilanceve te tre viteve te fundit te paraqitur prane autoritetit perkates te konfirmuara nga ky autoritet.Kjo kerkese konsiderohet e permbushur nese ne dy bilance te njepasnjeshme nuk ka raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivitet..

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vertetimet që dëshmojnë se operatori ekonomik **ka paguar detyrimet përkatëse**, për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitetet për vitin 2023, sipas ligjit 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c dhe neni 55, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe në pikën 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe bazuar ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare perkatësisht 2021, 2022 dhe 2023, Per te vertetuar plotesimin e këtij kushti OE duhet te paraqese kopje te bilanceve te tre viteve te fundit te paraqitur prane autoritetit perkates te konfirmuara nga ky autoritet.Kjo kerkese konsiderohet e permbushur nese ne dy bilance te njepasnjeshme nuk ka raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivitet.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme perfshirjen e kriterit te cituar me lart, ne menyre qe t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesemarrës te mundshem si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të ligjit nr.25/2018 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, qe eshte realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, ne nje vlere jo me te madhe se 20% te vleres se perlllogaritur te kontrates qe prokurohet (neni 55/4/b i vkm-se 285/2021)

a. Kjo pikë përmbushet me vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatëtri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 40, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

3.1 Subjekti Ofertues duhet të disponojë minimalisht 1 (një) stacion të tregëtimit me pakicë të karburantit brenda territorit të Bashkisë Mirditë, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate noteriale ose akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKB-së, etj).

- Ky stacion furnizimi të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B (*sipas shtojces 1 të ligjit 52/2020, Veprimtaria: Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane, Kapaciteti kufi për lejet e tipit B - Të gjitha instalimet*), Vërtetim Teknik të leshuar nga Organet e Miratuara të Vlersimit të Konformitetit (OMVK) ose nga një shoqëri e akredituar, Certificate e mbrotjes nga zjarri leshuar nga M.Z.SH dhe Police sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributore të shitje me pakicë, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmerisë të datës e hapjes së ofertave.

3.2 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me **Vërtetim Teknik** nga Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial (Rekomandimi nr 5168 prot date 18.07.2024) si dhe leje tregtimi/ Autorizim për tregëtim karburantesh me pakicë (Gazoi/Diesel), sikurse përcaktohet në (VKM-në me nr.538 datë 26.05.2009, vkm 970 date 02.12.2015, Ligji nr.8450 dt.24.02.1999)

Argumentimi:

Këto kritere janë vendosur që operatorët ekonomik të jenë të pajisur sipas ligjit me lejet dhe autorizimet përkatëse për trejetimin e këtij malli, në zbatim të Ligjit nr.8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës , të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 970, datë 02.12.2015. VKM-në me nr.538 datë 26.05.2009,vkm, Ligji nr.8450 dt.24.02.1999), si dhe ne perputhje me rekomandimin nr 5168 prot date 18.07.2024

Kriteret e vendosur në referencë të dispozitave të sipërcituar, përcaktojnë se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm, vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, dhe duhet të jetë i pajisur me licencat profesionale, të lëshuara nga autoritete kompetente shtetërore, që vërtetojnë pajtueshmërinë e ofertuesit me standardet e kërkuara në legjislacionin e sipërpërmendur. Pra konsiderohen si kritere të lidhura ngushtësisht me objektin e kontratës që prokurohet dhe i bazuar në LPP.

2.3.6 Subjekti ofertues duhet te paraqese dhe deklaratat si me poshte:

- Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se ofron një faqe të menaxhimit të karburanteve (webpage) ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet duke përdorur kartën elektronike.

Kjo faqe e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, dhe nga Ilogaria elektronike e AK në mjetet e transportit, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti Kontraktor.

Mosofrimi i faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), përbën kusht për skualifikim.

- Subjekti duhet te deklaroje se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë në shërbim 24 orë në cdo ditë të javës, me kartë elektronike të personalizuar me targën e cdo automjeti të autoritetit kontraktor, sipas kerkesave të autoritetit kontraktor, deri në përfundim të afateve të efektivitetit të kontratës; *(Deklarate nga subjekti ofetues.)*
- Subjekti duhet te deklaroje se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike. *(Deklarate nga subjekti ofetues.)*

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që mund të dorëzojnë dëshmi për rezultate e testime zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

3.3.1 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë “Vertetimet Teknike per repektimin e normave dhe te kushteve teknike ne instalimet teknologjike per depozitimin, transportimin dhe tregtimin naftes, te gazit dhe nenprodukteve te tyre leshuar nga Organet e miratuara te Vleresimit te Konformitetit, te akredituara ne fushen e certifikimit dhe te inspektimit teknik te linjave teknologjike ne fushen e hidrokarbureve” (rekomandimi nr 5168 prot date 18.07.2024)*

3.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Vërtetim nga organet e miratuara te Vleresimit te Konformitetit (OMVK) , që te provoje se ka importuar dhe /ose ka tregetuar karburante sipas standarteve te legjislacionit Shqiptar dhe ofertuesi nuk ka pasur penalitete për shkelje të cilësisë të karburantit, për vitin 2023.*

3.3.3 **Subjekti duhet të deklarojë** se furnizimin me naftë ne institucione arsimore), do të bëhet me automjet të posaçëm nga ana e operatorit ekonomik sipas kërkesës së autoritetit kontraktor (ne te gjitha institucionet arsimore) dhe çmimi i transportit do të përfshihet brenda çmimit të ofertës. Automjeti do të shoqërohet nga personi përfaqësues i Autoritetit Kontraktor në çdo rast furnizimi, përfaqësues ky i cili do të disponojë kartën tip elektronike për kryerjen e veprimeve në stacionin e furnizimit me lëndë djegëse. (Deklarate)

3.3.4 *Operatori ekonomik duhet te zoteroje (ne pronesi apo me qera) 1 (nje) mjet autobot per transportin e karburantit sipas kerkeses e AK. Autoboti te jete i paisur me Leje Qarkullimi, Kolaudimi (SGS), police sigurimi, certifikate per transportin e mallrave te rrezikshme dhe pasaporta e mjetit lidhur me kapacitetin mbajtes. Ne rastin kur autoboti eshte me qera subjekti ofertues duhet te paraqese kontraten noteriale te qerases.*

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Ne respektim te nenit 36, 37 të LPP-se në të gjitha rastet kur permendet “marke” perfshihet termi “ekuivalent”.

Sqarim per ofertuesit: Ne respektim dhe zbatim te **Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “ Per Prokurimin Publik ” neni 82 dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te**

prokurimit publik”,neni 26 neni 39, Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake**, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe nenit 26 të VKM nr.285, date 19.05.2021.

Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti kontraktor detyrimisht do t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

SPECIFIKIME TEKNIKE

STANDARTI I GAZOILIT (DIEZEL) (10ppm)g

Gazoil S SH EN 590: 2022.

Gazoil standart

Kërkesa të përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provave

Nr	Emërtimi	Njësia	Kufijtë e lejuar		Metoda e Testimit
			Min	Max	

1	Numri i Cetanit		51	—	SSH EN ISO 5165 SSH EN 16144 SSH EN 5195 EN 16715
2	Indeksi i Cetanit		46.0	—	SSH EN ISO 4264
3	Densiteti në 15°C	Kg/m ³	820	845	EN ISO 3675 dhe 12185
4	Hidrokarbure Aromatike Policiklike	% (m/m)	—	8	SSH EN ISO 12916
5	Përmbajtja e Squfurit	mg/kg	—	10.0	SSH EN ISO 20846 SSH EN ISO 13032 SSH EN ISO 20884
6	Përmbajtja e Manganit, nga 01.01.2014 e në vazhdim	mg/l	—	2	SSH EN ISO 16576
7	Pika e Ndezjes	°C	Mbi 55		SSH EN ISO 2719
8	Mbetje Karboni	% (m/m)	—	0,30	SSH EN ISO 10370
9	Përmbajtja e Hirit	% (m/m)	—	0,01	SSH EN ISO 6245
10	Përmbajtja e Ujit	mg/kg	—	200	SSH EN ISO 12937
11	Kontaminimi Total	mg/kg	—	24	SSH EN ISO 12662
12	Gryerja e shiritit të bakrit (3 orë në 50 ⁰ C)	grada	KLASI I		SSH EN ISO 2160
13	Përmbajtja e acidit të ngopur metilester	% (vV/V)	—	7	SSH EN 14078
14	Qëndrueshmëria e oksidimit	g/m ³ h	20	25	SSH EN ISO 12205 SSH EN 15751
15	Lubrifikimi, diametrik i veshjes së mprehtë (ësd 1,4) në 60 °C	um(microm)	—	460	SSH EN ISO 12156-1
16	Viskozitetit në 40 ⁰ C		2,000	4,500	SSH EN ISO 3104
17	Destilimi % vol e destilati qe vlon deri ne 250°C % vol e destilati qe vlon deri ne 350°C Distilati qe vlon ne 95 % vol.	%(v/v) %(V/V) °C	85	<65 360	SSH EN ISO 3405 SSH EN ISO 3924

U plotesua paketa standarte nga njesia e prokurimit dhe u autorizua Manjola Doda per te hedhur proceduren ne sistem.

Procedura e tenderit caktua te zhvillohej me date 09.09.2024 ora 10.00

NJESIA E PROKURIMIT